



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1158/1 Prot.

Tiranë, më 13 / 08 / 2020

V E N D I M

Nr. 87, Datë 13 / 08 / 2020

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 39, datë 01.06.2020, të paraqitur nga N.N kundër Bashkisë Gjirokastrë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike¹”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Në datë 05.06.2018 ka filluar punë në pozicionin si specialiste për marrëdhëniet me publikun, në Agjencinë e Shërbimeve Publike, të Bashkisë Gjirokastrë. Në datë 23.01.2020 është njoftuar për shkurtimin e pozicionit të punës, për shkak të ristrukturimit. Nga ajo datë e në vijim është mbajtur me shpresë nga Drejtori dhe Kryetari i Bashkisë, se do të gjendej një hapësirë për një pozicion tjetër pune. Ankuesja shkonte rregullisht në punë, dhe në datë 05.03.2020 është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, që prej datës 23.02.2020. N.N informon se, ndërkohë që ajo mbahej me shpresë dhe ikja e saj justifikohet me shkurtim të vendit të punës, janë punësuar dy persona të tjerë në po këtë agjenci. Ankuesja shprehet se e gjitha ka ndodhur për arsye se është anëtare e LSI-së dhe nuk ka votuar në zgjedhjet e vitit 2019”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në vendin e punës.

¹ Referuar kartës së anëtarësisë nr. 6650, datë 29.04.2016, N.N është anëtare e subjektit politik: Lëvizja Socialiste për Integritim.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj anekse, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 39, datë 01.06.2020 të N.N u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 601/2, datë 04.06.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Bashkia Gjirokastrë për ankesën e bërë nga N.N si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të plotë të dosjes personale të N.N. (Emërimi, kontrata e punës, vlerësime të performancës, masa disiplinore, nëse ka, Librezë Pune, etj).
 - Kopje të plotë të procedurës së largimit nga detyra të punonjësës N.N.
 - Informacion nëse është parë mundësia e risistemimit të N.N në një pozicion tjetër pune, pranë Bashkisë Gjirokastrë.
 - Kopje të strukturës dhe organikës së vjetër të Bashkisë Gjirokastrë.

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Kopje të vendimit/relacionit/studimit të bërë mbi ristrukturimin e Bashkisë Gjirokastër dhe kriteret e përdorura për përzgjedhjen e punonjësve që do largoheshin apo ndryshonin pozicionin e punës për shkak të ristrukturimit.
 - Kopje të plotë të Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 154, datë 26.12.2019 “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave në Bashkinë Gjirokastër”.
 - Kopje të plotë të Urdhërit nr. 35, datë 21.01.2020 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e organogramës së administratës së Bashkisë Gjirokastër”, i ndryshuar.
 - Emrat e punonjësve që janë larguar nga puna, si pasojë e zbatimit të strukturës së re organike të Bashkisë Gjirokastër.
 - Emrat e punonjësve që janë transferuar nga një pozicion në një pozicion tjetër, si pasojë e zbatimit të strukturës së re organike të Bashkisë Gjirokastër.
 - Numrin e punonjësve të rinj të emëruar në Bashkinë Gjirokastër, pas miratimit të stukturës së re.
- Me e-mail-in datë 03.06.2020, inspektori i çështjes, ka kërkuar nga subjekti ankues, plotësimin e ankesës me informacion mbi personat të cilët ishin ripunësuar nga ana e Bashkisë Gjirokastër në agjencinë e ristrukturuar.
 - Me e-mail-in datë 05.06.2020, subjekti ankues ka informuar se dy punonjësit e përmendur në ankesë janë: M.B (i cili ka qenë i punësuar tek Drejtoria e Tatim-Taksave të Bashkisë) dhe TH.M (e cila ka qenë e punësuar në Drejtorinë e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore në Bashki), të dy këto punonjës kanë kaluar asistentë në Drejtorinë e Shërbimeve Komunitare, Utilitare të Bashkisë Gjirokastër.

Me shkresat nr. 4310/1, datë 11.06.2020 dhe nr. 4310/2, datë 16.06.2020, Bashkia Gjirokastër ka dërguar pranë Komisionerit, dokumentacionin e kërkuar dhe parashtimet si vijon: “N.N me pozicion pune, Specialiste për Marrëdhëniet me Publikun në ish Agjencinë e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Gjirokastër, i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare për shkak të ristrukturimit, në datë 23.02.2020. Bashkia Gjirokastër bazuar në afatet e njoftimit ka zbatuar procedurën për largimin nga puna të punonjësës N.N. Në Bashkinë Gjirokastër, pas datës 21.01.2020 janë emëruar 35 punonjës brenda dhe jashtë shërbimit civil”.

- Me shkresën nr. 768, datë 18.06.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga Bashkia Gjirokastër dokumentet si më poshtë:
 - Kopje të përshkrimit të punës dhe kualifikimet për pozicionet e punës: “specialist i burimeve njerëzore”, “specialist i marrëdhënieve me publikun”, “përgjegjës i sektorit të financës”, “financier, kontabilist”, “llogaritar/arkëtar” dhe “inspektor terreni” të Agjencisë së Shërbimeve Publike (sipas strukturës së vjetër).
 - Kopje të përshkrimit të punës dhe kualifikimet për pozicionin e punës: “inspektor për kontrollin në terren dhe ndjekjen e debitorëve” të Agjencisë së të Ardhurave (sipas strukturës së vjetër për punonjësin, M.B).

- Kopje të përshkrimit të punës dhe kualifikimet për pozicionin e punës: “specialist asistent” të Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare, Utilitare (sipas strukturës së re).
- Kopje të relacionit të bërë nga Komisioni i Ristrukturimit mbi ristrukturimin e Agjencisë së Shërbimeve Publike në Drejtorinë e Shërbimeve Komunitare, Utilitare dhe kriteret e përdorura për përzgjedhjen e punonjësve që do largoheshin apo ndryshonin pozicionin e punës për shkak të ristrukturimit.
- Kopje të procedurës së konkurimit dhe përzgjedhjes së punonjësve në pozicionin “specialist asistent” në Drejtorinë e Shërbimeve Komunitare, Utilitare: (vlerësimi me pikë nga Komisioni).
- Informacion nëse është parë mundësia e transferimit të N.N në një pozicion tjetër pune, duke konstatuar se dhe punonjës të tjerë të Agjencisë së Shërbimeve Publike (5 punonjës) janë transferuar në detyra të tjera brenda bashkisë.

Me shkresën nr. 4769/1, datë 10.07.2020, Bashkia Gjirokastrë ka dërguar pranë Komisionerit, parashtrimet si vijon: *“Bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 116, datë 30.09.2019 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 143, datë 30.12.2018 “Për njësitë shpenzuese” është bërë ndryshimi i strukturës organizative, administrative dhe buxhetore të bashkisë që konsiston në mbylljen e agjencive. Bashkia Gjirokastrë do të jetë njësisë e vetme shpenzuese dhe si rrjedhojë, Sektori i Financës, i Burimeve Njerëzore, pozicioni i arkivës dhe magazina e të gjitha agjencive do të përqëndrohej në një. Këto sektorë, pjesë të agjencive do të jenë pjesë e ristrukturimit. Pozicionet e zëvendës drejtorit, specialistit të burimeve njerëzore, punonjës arkive, magazinë, sektori i financës dhe inspektorë terreni të Agjencisë së Shërbimeve Publike kanë qenë pjesë e ristrukturimit dhe funksionet e tyre i kanë kaluar burimeve njerëzore, arshivës, magazinës dhe financës së bashkisë. Me ristrukturimin e bashkisë, në Agjencinë e Shërbimeve Publike, struktura e re është miratuar me tre asistentë dhe sektorët e tjerë kanë ngelur të pandryshuar. Punonjësit për të cilët i është mbyllur vendi i punës, kanë nisur procedurat për përfundimin e marrëdhënieve të punës. Punonjësit e Agjencisë së Shërbimeve Publike kanë qenë punonjës të cilët trajtoheshin me Kodin e Punës dhe si rrjedhojë nuk është ngritur komision ristrukturimi. Nga ana e bashkisë, është bërë përpjekje për të kryer sistemimin e punonjësve të cilëve ju bë shkurtimi i vendit të punës dhe përparësi kanë pasur punonjësit me më shumë vite eksperiencë pune. Lidhur me pretendimin për punonjësin M.B, informohet se nuk i është mbyllur pozicioni i tij i punës kur është bërë procesi i ristrukturimit por është transferuar nga Agjencia e të Ardhurave nga pozicioni i inspektorit për kontrollin në terren si asistent në Drejtorinë e Shërbimeve Komunitare Utilitare”.*

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Subjekti ankues ka lidhur marrëdhëniet e punës me Bashkinë Gjirokastrë, me datë 06.06.2018, në pozicionin, specialiste e marrëdhënieve me publikun, pranë Agjencisë së Shërbimeve Publike, nëpërmjet Kontratave Individuale të Punës, datë 06.06.2018, 06.10.2018 dhe 06.03.2019. Me shkresën nr. 591, datë 23.01.2020 të Bashkisë Gjirokastrë, është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit. Me shkresën nr.1950, datë 28.02.2020 të Bashkisë Gjirokastrë, *“Urdhër nr. 131, datë 28.02.2020 “Për ndërprerje të marrëdhënieve financiare”*”, N.N është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare me datë 23.02.2020.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

- Referuar Urdhrit nr. 19, datë 16.01.2019 të Bashkisë Gjirokastrë *“Për miratimin e strukturës së administratës së bashkisë dhe njërive shpenzuese në varësi të Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2019”* organika e Bashkisë Gjirokastrë përbëhej nga 632 punonjës, ndërsa Agjencia e Shërbimeve Publike përbëhej nga 183 punonjës.
- Mbështetur në Vendimin nr. 116, datë 30.09.2019 të Këshillit të Bashkisë Gjirokastrë *“Për një ndryshim në Vendimin nr.143, datë 30.12.2018, të Këshillit të Bashkisë Gjirokastrë, në lidhje me strukturën e njërive shpenzuese”*, Këshilli Bashkiak ka vendosur ndryshimin e strukturës organizative, administrative dhe buxhetore të Bashkisë Gjirokastrë duke mbyllur njësitë shpenzuese në varësi të Bashkisë Gjirokastrë dhe përkatësisht: Agjencisë së Mirëqënies dhe Kujdesit Social, Agjencisë së Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sporteve, Agjencisë së Shërbimeve Publike dhe Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore dhe numri total i punonjësve të ishte 632 punonjës.
- Referuar Vendimit nr. 154, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Gjirokastrë *“Për miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe niveleve të pagave në Bashkinë Gjirokastrë”* është vendosur që numri maksimal i punonjësve në Bashkinë Gjirokastrë të ishte 590 punonjës.
- Referuar strukturës organike të Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2020 të dërguar bashkëngjitur me Urdhërin nr. 35, datë 21.01.2020 të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, Drejtoria e Shërbimeve Komunitare, Utilitare (ish Agjencia e Shërbimeve Publike) do të përbëhej nga 173 punonjës, dhe administrata e drejtorisë do të përbëhej nga një drejtor dhe 3 punonjës, specialistë asistentë.
- Referuar kontratës së punës së N.N, rezulton se marrëdhëniet e punës së saj me Bashkinë Gjirokastrë janë rregulluar sipas kërkesave të Kodit të Punës.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, lidhur me ristrukturimin e Agjencisë së Shërbimeve Publike, rezulton se të gjithë punonjësit e administratës që kanë punuar pranë kësaj strukture, bazuar në procedurat e parashikuara në Kodin e Punës, janë njoftuar për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, por për një pjesë të tyre (pesë punonjës) është vendosur më pas transferimi në një detyrë tjetër brenda strukturave të Bashkisë Gjirokastrë.

Referuar strukturës dhe organikës së Agjencisë së Shërbimeve Publike, rezulton se struktura e agjencisë përbëhet nga 183 punonjës dhe administrata përbëhet nga drejtori dhe 11 punonjës, ndërsa me strukturën e re, Drejtoria e Shërbimeve Komunitare, Utilitare do të përbëhet nga 173 punonjës, dhe administrata do të përbëhet nga drejtori dhe 3 punonjës. Pra rezulton që pozicioni i punës ku punonte ankuesja do të shkrihet. Referuar strukturës së vjetër administrata e agjencisë përbëhet nga: drejtori, z/drejtori, specialisti i burimeve njerëzore, punonjës arkive dhe magazinier, specialist i marrëdhënieve me publikun, përgjegjës i sektorit të financës, financier/kontabilist, llogaritar/arkëtar dhe 4 inspektorë terreni. Referuar strukturës së re, administrata e drejtorisë do të përbëhet nga: drejtori dhe 3 specialistë asistentë. Pra, rezulton se administrata do të shkurtohet me 8 punonjës dhe pozicioni i ankueses nuk do të ekzistonte në strukturën e re.

Referuar dokumentacionit të administruar rezulton se në administratën e strukturës së re, në pozicionet si specialist asistent, kanë qëndruar dy punonjës (A.Ç, ish specialiste e burimeve njerëzore dhe L.H ish llogaritar/arkëtar) dhe është transferuar M.B nga detyra e inspektorit për kontrollin në terren të Drejtorisë së të Ardhurave në detyrën e specialistit asistent.

Gjithashtu, referuar dokumentacionit të dërguar nga Bashkia Gjirokastrë rezulton se janë transferuar në detyra të tjera dhe punonjësit: E.S (ish z/drejtor), F.LL (ish punonjës arkive dhe magazinier), I.D (ish përgjegjës i sektorit të financës), ndërkohë që i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, ankueses dhe dy punonjësve të tjerë: F.M (ish financier/kontabilist dhe A.M (ish inspektor terreni), ndërsa për 3 inspektorë terreni nuk ka dokumentacion lidhur me marrëdhëniet e punës.

Lidhur me pretendimin e ankueses se dhe punonjësja TH.M është transferuar pranë Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare, Utilitare, rezulton se: *“Punonjësja TH.M me shkresën nr. 629, datë 24.01.2020 është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit ndërsa me Urdhrin nr. 128, datë 28.02.2020 “Për ndërprerje të marrëdhënieve financiare” i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare në datë 24.02.2020”.*

Referuar informacionit të dërguar nga Bashkia Gjirokastrë me shkresën nr. 4769/1, datë 10.07.2020, në të cilën ka deklaruar se për sistemimin e punonjësve kanë pasur përparësi punonjësit me më shumë vite eksperiencë pune, rezulton se të gjithë punonjësit e sipërcituar kanë pasur vjetërsi në punë më shumë se ankuesja e cila ka rreth 1 vit e 8 muaj vjetërsi në punë³.

Komisioneri vlerëson se punonjësi M.B për shkak të vjetërsisë në punë⁴ është vlerësuar nga ana e Bashkisë Gjirokastrë se plotëson më mirë kriterin se ankuesja dhe përvoja e punës e M.B ka qenë elementi që ka prevaluar në transferimin e tij në pozicionin si Specialist Asistent pranë Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare, Utilitare.

³ Referuar librezës së punës të subjektit ankues.

⁴ Referuar Urdhrit nr.146, datë 03.03.2020 të Bashkisë Gjirokastrë “Për transferim në detyrë”, punonjësi M.B ka 20 vite vjetërsi në punë.

Pra, vetë ankuesja N.N nuk është në kushtet e vlerësimit të njëjtë nga ana e Bashkisë Gjirokastrë, që të mund të merrej në konsideratë, për efekt krahasimor elementi “bindja politike”.

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, Komisioneri nuk ka tagër të gjykojë mbi nevojat apo procesin e ritrukturimit të një institucioni si Bashkia Gjirokastrë, por mbështetur në atributet që i jep Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mund të kryejë konstatim, nëse ankuesja i është nënshtruar apo ekspozuar një qëndrimi të padrejtë, disfavorizues apo të pabarabartë, nga ana e Bashkisë Gjirokastrë, në krahasim me punonjës të tjerë që ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, në kuptim të nenit 7, pika 1 të këtij ligji.

Mbështetur në analizimin e fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se nuk ndodhemi në kushtet e trajtimit të pabarabartë të ankueses, në krahasim me punonjës të tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme, me të, nga ana e Bashkisë Gjirokastrë.

Për sa më sipër, në mungesë të trajtimit të pabarabartë të ankueses nuk ndodhemi në kushtet e diskriminimit për shkakun e pretenduar nga N.N, nga ana e Bashkisë Gjirokastrë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, nenin 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetases N.N nga ana e Bashkisë Gjirokastrë për shkak të bindjes politike.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTORE JURIDIKE**

Ardiana HALA

Shkaku: Bindja politike
Fusha: Punësim